

**VENDIM**  
**Nr. 429, datë 15.7.2021**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME TË HARTIMIT TË  
PLANIT TË RILEVIMIT PËR ZONAT E STIMULUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 48, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Plan rilevimi është harta digjitale dhe manuale, e hartuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim, ASHK), që përftohet nga verifikimi në terren, ku pasqyrohet gjendja faktike ndërtimore, kufijtë e zonës së stimuluar, si dhe të dhënat e hartës kadastrale.

2. Plani i rilevimit i zonës së stimuluar pasqyron kufijtë, përmasat dhe pozicionin gjeografik për:

- a) njësitë ndërtimore;
- b) truallin funksional të njësive ndërtimore;
- c) truallin e lirë brenda zonës së stimuluar.

3. Plani i rilevimit shoqërohet në çdo rast nga relacioni shpjegues i gjendjes juridike të pasurive brenda zonës së stimuluar, i cili përmban:

- a) të dhënat kadastrale të pasurive (të dhënat e regjistrimit kadastral) brenda zonës së stimuluar;
- b) të dhënat nga dokumentacioni për miratimin e zonës së stimuluar;
- c) të dhënat për kërkesat e paraqitura për kalimin e pronësisë;
- ç) të dhënat për vendimmarrje për njohje, kthim apo kompensim në kuadër të legjislacionit për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave.

4. Drejtoria vendore e ASHK-së, kompetente për zonat e stimuluar, harton planin e rilevimit dhe relacionin shpjegues, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e përfundimit të verifikimit në terren të zonës së stimuluar.

5. Plani i rilevimit në format digjital e manual dhe relacioni shpjegues i përcillet drejtorisë vendore të ASHK-së, kompetente për territorin ku ndodhet zona e stimuluar, e cila përgatit kartelat e pasurive të paluajtshme.

6. Në zonat kadastrale, ku ka përfunduar regjistrimi fillestar, kur konstatohet se ka mospërputhje ndërmjet hartës kadastrale dhe planit të rilevimit, drejtoria vendore e ASHK-së, kompetente për territorin ku ndodhet zona e stimuluar, kryen procedurat e përmirësimit të regjistrimit sipas planit të rilevimit, në përputhje me kreun VI, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

7. Plani i rilevimit dhe lista e përfituesve me të dhënat nga kartela e pasurisë së paluajtshme, hartuar sipas pikës 5, të këtij vendimi, i nënshtrohen procesit të konsultimit publik, në përputhje me nenin 31, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”. Procedurat e konsultimit publik ndiqen nga drejtoria vendore e ASHK-së, kompetente për zonat e stimuluar.

8. Nga data e përcjelljes së planit të rilevimit nga drejtoria vendore kompetente për zonat e stimuluar, sipas pikës 5, të këtij vendimi, dhe deri në përfundimin e procedurës së konsultimit publik, drejtoria vendore e ASHK-së, kompetente për territorin ku ndodhet zona e stimuluar, duhet të pezullojë veprimet me pasuritë brenda zonës së stimuluar.

9. Pas përfundimit të konsultimit publik dhe trajtimit të ankesave, harta, kartelat e pasurive të paluajtshme dhe dokumentacioni tekniko-ligjor legjitimohen nga drejtoria vendore e ASHK-së, kompetente për territorin ku ndodhet zona e stimuluar. Me legjitimim kuptohet miratimi nga drejtoria vendore e ASHK-së, kompetente për territorin ku ndodhet zona e stimuluar, i planit të

rilevimit dhe listës së përfituesve me të dhënat nga kartela e pasurisë së paluajtshme, që i është nënshtruar konsultimit publik, dhe përfshirja e tij në bazën e të dhënave.

10. Kur për shkak të sipërfaqes apo pozicionimit të zonës së stimuluar drejtoria kompetente vendore e ASHK-së e ka të pamundur kryerjen e procesit të verifikimit në terren, në kuadër të hartimit të planit të rilevimit, ky proces mund të kryhet nga subjekte private të licencuara në fushat përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

11. Kur gjendja faktike, e pasqyruar në planin e rilevimit të miratuar përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, por të paregjistruar në regjistrat kadastralë, ka pësuar ndryshime, drejtoria vendore e ASHK-së, kompetente për zonat e stimuluar, mund të rishikojë planin e rilevimit. Plani i rishikuar do t'u nënshtrohet rregullave të hartimit të parashikuara në këtë vendim.

12. Nëse plani i rilevimit i miratuar përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi është pasqyruar në regjistrat kadastralë dhe një pjesë e pasurive në të kanë pësuar ndryshime, drejtoria vendore e ASHK-së, kompetente për zonat e stimuluar, nis procesin e përmirësimit për bllokun kadastral, i cili është prekur nga ndryshimet, proces që përfundohet nga drejtoria vendore e ASHK-së, kompetente për territorin ku ndodhet zona e stimuluar, në përputhje me kreun VI, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën".

13. Paraqitja grafike e planit të rilevimit për zonat e stimuluar miratohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së.

14. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Erion Braçe**